



Kostoja e emigrimit të rinjve

Western Balkans
Democracy Initiative



Përmbajtja

P

Parathënie

[Faqja 3](#)

H

Hyrje

[Faqja 4](#)

T

Të gjeturat kryesore

[Faqja 7](#)

1

Statistikat e migrimit

[Faqja 9](#)

2

Natyra ekonomike e migrimit

[Faqja 17](#)

3

Kostoja e Emigrimit të Rinisë

[Faqja 26](#)

4

Përfundime

[Faqja 48](#)

3.1
Cili është çmimi i përgjithshëm i
shkollimit të përfunduar në vitim 2018?
[Faqja 28](#)

3.2
Cilat janë ndikimet në
Aktivitetin Ekonomik
[Faqja 35](#)

3.3
Përfitimet ekonomike të migrimit
të popullsisë
[Faqja 39](#)

Parathënie


Ky studim hulumtues lidhur me “Koston e emigrimit të rinjve” është i pari i llojit të tillë që sjell të dhëna lidhur me emigracionin e Kosovës dhe që i përgjigjet në një pyetje të thjeshtë: Sa i kushton Kosovës emigrimi i të rinjëve? Një pyetje shumë e thjeshtë por, që lidhet me një çështje shumë komplekse. Edhe pse ekzistojnë hulumtime lidhur me shkaqet e ndryshme të emigrimit, që është një fenomen kompleks dhe global dhe, që ka ekzistuar që nga fillimet e njëzimit, deri më tani nuk ka patur ose ka patur shumë pak të dhëna ose dëshmi lidhur me koston reale të emigrimit. Ky studim hulumtues paraqet një vlerësim të kostove dhe ndikimit financiar në Kosovë si dhe humbjeve të shkaktuara nga numri tejet i lartë i njerëzve që çdo vit largohen nga Kosova. Hulumtimi përcakton sasinë e efekteve dhe implikimeve të emigrimit në ekonominë e përgjithshme të Kosovës si dhe humbjeve të prodhimit të brendshëm bruto (PBB), duke analizuar së afërmi se si harxhohen remitancat. Qëllimi i studimit është që këto të dhëna t’u prezantohen palëve të interesuara, publikut, mediave si dhe aktorëve shtetëror dhe jo-shtetëror.

Shpresojmë që këto të dhëna do të shfrytëzohen nga një aleancë e gjërë e palëve të interesuara në Kosovë, aleancë e cila më pastaj do të mund të prezantojë zgjidhje përmes politikave lidhur me atë se si të trajtohet dhe të zvogëlohet kostoja e emigrimit të të rinjve si dhe efekteve negative të tij. Gjithashtu, shpresojmë që studimi do të inicojë një diskutim më të gjërë lidhur me temën e emigrimit të të rinjve. Studimi u realizua nga organizata jo-fitimprurëse dhe jo-partiake Democracy Plus (D+) nga Kosova me përkrahjen e Fondacionit të Uetsmisterit për Demokraci (WFD). Studimi u përkrah nga Instituti për inovacion dhe zhvillim përmes trajnimit të D+ në metodologjinë e hulumtimit dhe mbledhjen e të dhënave.

Fondacioni falenderon Democracy Plus (D+) për këtë studim gjithpërfshirës dhe të thellë, si edhe Qeverinë Britanike për përkrahjen për përmbyllen e studimit. Fondacioni i Uetsmisterit për Demokraci (WFD) është institucion publik i Mbretërisë së Bashkuar (MB) që përkrah zhvillimin e demokracisë në mbarrë botën.

Në Gusht të vitit 2018 WFD filloi iniciativën shumëvjeçare regjionale për Ballkanin Perëndimor të quajtur “Inicijativa për Demokraci në Ballkanin Perëndimor”. Inicijativa është financiarisht e përkrahur nga Fondi për konflikt, stabilitet dhe siguri i Qeverisë Britanike.

Emil Atanasovski
Drejtore për Ballkanin Perëndimor
WFD



Hyrje

Njerëzit kanë migruar që nga fillimi i civilizimit. Në mënyrë vullnetare apo më force, individualisht apo në grupe, në mënyrë spontane apo sistematike, njerëzit kanë ndërruar vendbanimet e tyre. Në kërkim të ushqimit dhe ujit, për të shmangur katastrofat natyrore apo luftrat, duke kërkuar kushte më të mira për jetesë apo një mjedis me më shumë të drejta njerëzore, njerëzit kanë migruar në qytete, vende apo kontinente të ndryshme duke krijuar situatën e sotshme ku tre përqind e popullatës botërore, apo më shumë se një e katërta e një miliard njerëzve, jetojnë jashtë vendit të tyre të origjinës.

Shfaqja dhe ndërtimi i kapitalizimit si dhe revolucioni industrial i dhanë një dimension të ri mobilitetit të njerëzve. Gjatë shekujve të XIX dhe XX, konfliktet e armatosura ishin faktor me rëndësi në persekutim dhe ndryshim të vendbanimeve. Sot, ndryshimet klimatike dhe kushtet e jetesës janë faktorët më të rëndësishëm. Sipas një raporti të vitit 2018 të Bankës Botërore, më shumë se 143 milionë njerëz mund të bëhen “migrues të klimës” për shkak të vërshimeve, thatësirave dhe mungesës së ujit. Është e qartë që, pavarësisht qëllimit, migrimi do t’a përcjell njerëzimin përderisa të ka njerëz dhe vende për të shkuar. Edhe pse skenat e njerëzve që lëshojnë shtëpitë e tyre për shkak të konflikteve apo tërmeteve shkatërruese lënë përshtypje të forta, krijojnë hidhërim dhe na bëjnë që të lidhim migrimet e popullatës me shkaqe të dhunshme, faktet sot tregojnë që arsyet për ndryshim të vendbanimit janë pak më njerëzore.

Përsheptimi i procesit të globalizimit pas Luftës së Dytë Botërore lidhi më tej rajone të ndryshme të sistemit global dhe ripërcaktoi ndërveprimin e tyre falë zhvillimit të teknologjive të reja. Me zhvillimin e transportit, bota është bërë një vend më i vogël, dhe me lëvizjen e lirë të mallrave dhe kapitalit, fuqia punëtore ndeshet me barriera më të ulëta në lëvizje, ndërsa në disa raste ajo merr stimulim shumë të qartë pozitivë përmes programeve tërheqëse në shumë vende për të tërhequr fuqi punëtore cilësore.

Ndryshe nga disa vende të Evropës Lindore, popullsia e të cilave filloi të migrojë në numër të konsiderueshëm vetëm kur u bënë anëtare të Bashkimit Evropian, popullsia e ish-Jugosllavisë gjysmë shekulli më parë filloi fluksin e migrimit masiv në Perëndim me mbështetjen e vendeve nga të dy anët. Kështu, një vend plotësoi mungesën e fuqisë punëtore në sektorin primar, ndërsa tjetri ishte i kënaqur me remitancat nga punëtorët migrantë, për të cilët nuk kishte kapacitete në ekonominë e vet të pazhvilluar.

1.
Banka Botërore
(2018). Groundswell:
Preparing for Internal
Climate Migration,
World Bank (2018)
[Momentumi i
krijuar: Përgatitja për
Migrimin e Brendshëm
Klimatik]. [https://
www.worldbank.
org/en/news/
feature/2018/03/19/
meet-the-human-
faces-of-climate-
migration.](https://www.worldbank.org/en/news/feature/2018/03/19/meet-the-human-faces-of-climate-migration)

Migrimet e sotme ndikohen nga një gamë e gjerë faktorësh “shtytës” dhe “tërheqës”. Rrallë këta faktorë duket të jenë të ndërthurur në mënyrë komplekse diku tjetër si në rajonin e Ballkanit. Luftërat, tranzicioni, paqëndrueshmëria politike, ndarjet etnike dhe fetare, korrupsioni, kushtet e punës dhe mundësitë e punësimit, shkolla dhe sistemet shëndetësore që mbeten prapa vendeve të zhvilluara dhe liritë seksuale të rrezikuara janë vetëm disa nga faktorët që ndikojnë në vendimet e njerëzve për të paketuar bagazhet e tyre.

Profili i migrantit të sotëm nga kjo zonë ka ndryshuar ndjeshëm në 50 vitet e fundit. Vetëm gjysmë shekulli më parë, shkuarja jashtë siguroi mundësi më të mira për një fuqi punëtore me aftësi të ulëta që mbetej fort e lidhur me vendlindjen, shpesh pa i zhvendosur familjet e tyre të ngushta. Sot, pjesa e sektorëve të arsimuar dhe shumë të kualifikuar të kontigjentit të migracionit po rritet, e cila shpesh iniciohet nga programe shumë tërheqëse në vendet e zhvilluara për vende specike të punës. Bashkimi familjar është më i zakonshëm se më parë. Ardhja e bashkëshortëve, fëmijëve dhe të afërmeve të tjerë të migrantëve kryesorë të mëparshëm është shpesh kategoria më e madhe e ardhjes në shumë vende.

Ndikimi i lëvizjeve të popullsisë në situatën socio-ekonomike në një vend imponon nevojën për të menaxhuar migrimin në të dy vendet e prekura. Nevojiten të dhëna adekuate për një vlerësim gjithëpërfshirës të natyrës, fushës dhe karakteristikave të këtij fenomeni, si dhe pasojave të tij. Sidoqoftë, ekzistojnë një numër kufizimesh për të dhënat administrative dhe statistikore sepse, në vende ose institucione të ndryshme, metodologjitë dhe përkufizimet mund të ndryshojnë në varësi të qëllimit për të cilin janë mbledhur.

Ky punim është një përpjekje për të përcaktuar sasinë e ndikimit të një trendi aktual të emigracionit në ekonominë e Kosovës, bazuar në statistikat demografike, statistikat e arsimit dhe të dhënat makroekonomike në dispozicion të publikut. Po ashtu, punimi kërkon të krijojë një bazë për analiza më të thella dhe më të hollësishme që do të vijin më vonë.

Tri pyetjet kryesore që ky punim kërkon t'u jap përgjigje janë:

1. Cila është kostoja mesatare e arsimimit të një personi me arsim të lartë?
2. Cila është kostoja oportune në aspekt të humbjes së prodhimit të brendshëm bruto të mundshëm (PBB) të gjeneruar nga emigracioni vjetor i popullsisë?
3. Cilat janë efektet pozitive të fluksit të migrimit në ekonomi?

Të gjeturat kryesore

Ky studim tregon se Kosova ndan fatin e rajonit për sa i përket lëvizjeve të migracionit dhe po përballet me një proces të intensifikuar të emigrimit të njerëzve të rinj dhe shumë të arsimuar. Specifikat që lidhen me Kosovën - luftërat, paqëndrueshmëria politike, institucionet e brishta në fazat fillestare të themelimit - vetëm e intensifikojnë këtë proces. Për më tepër, tradita e gjatë e emigrimit nga këto zona, lidhjet ende të forta të diasporës me vendlindjen dhe efekti i “rrugës së shkelur” kontribuojnë në intensifikimin e këtij procesi.

Për rininë, e cila zakonisht është pjesa më e lëvizshme e popullsisë, pamundësia për të gjetur një punë është një nga faktorët kryesorë shtytës. Papunësia në këtë pjesë të popullsisë është jashtëzakonisht e madhe në Kosovë, ku afërsisht gjysma e të rinjve nuk kanë asnjë shans për të gjetur ndonjë punë pas mbarimit të shkollës.


Statistikat zyrtare për migrim të hartuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ofrojnë të dhëna si për largimet e popullsisë ashtu edhe për hyrjet. Bilanci i këtyre lëvizjeve është vazhdimisht negativ, por me një ndryshueshmëri shumë të theksuar të shumave absolute. Pas një rekordi të arritur në vitin 2015, ku mbi 74,000 njerëz emigruan dhe vetëm një e katërta e këtij numri u regjistruan si emigrantë, pasuan dy vite me zbutje të këtij trendi. Pas kësaj, fluksi i emigrimit u intensifikua përsëri me bilanc negativ prej mbi 21.000 dhe pothuajse 29.000 të larguar, respektivisht në 2018 dhe 2019. Në përgjithësi, në periudhën nga 2015 deri në 2019, territori i Kosovës regjistroi një bilanc negativ migrimi prej mbi 120,000 njerëzve.

Ky hulumtim tregon që rreth 4.700 Euro janë investuar në arsimimin e secilit banor të Kosovës që ka kryer nëntë vite të shkollimit fillor në vitin 2018. Kostoja e arsimit të mesëm të lartë, që ka zgjatur tri vite dhe ka përfunduar në vitin 2018 (përfshirë filloren), ishte rreth 5.650 €, ndërsa për një student të diplomuar nga arsimi fillor deri në tri vite të shkollës së mesme, si dhe deri në fund të studimeve akademike që zgjati mesatarisht pesë vite dhe ka përfunduar në vitin 2018, rreth 9,700 € ishin investuar. Nëse këto rezultate individuale zbatohen për komponentin emigrant të popullsisë, rezultatet tregojnë se kostoja totale e arsimit të njerëzve që largohen nga Kosova në një vit, varësisht nga struktura arsimore, varion nga pak më shumë se 180 milionë euro në pothuajse 205 milionë euro.

Ndonëse është e pamundur të parandalohet largimi vjetor i popullsisë përmes punësimit, gjenerohet një humbje vjetore në PBB-në e mundshme në vlerë prej rreth 519 milionë euro. Për të thënë shkurtazi, çdo individ i punësueshëm që emigron nga Kosova merr mesatarisht gati 17.000 euro në vit në PBB-në e mundshme vjetore të ardhshme që mund të ishte realizuar nëse flukset ekonomike do të kishin mundësuar punësimin e tyre produktiv. Kjo humbje e PBB-së së mundshme nuk duhet të barazohet thjesht me humbjen e PBB-së reale që do të ndodhte në 2018, pasi ajo u shkaktua nga largimi i njerëzve që emigruan, kryesisht për shkak të paaftësisë së tyre për të gjetur një punë të përshtatshme dhe kështu të marrin pjesë në krijimin e vlerave të shtuara. Kjo shumë duhet të shihet përmes prizmit të humbjes së përhershme të potencialit për ekonominë e Kosovës.

Përfitimi kryesor nga emigrimi janë remitencat. Duke e pasë paraysh madhësinë e diasporës së saj, në aspekt të proporcionit të remitencave në BPP-në e saj, Kosova është në top vendet evropiane me remitenca që përbënë rreth 12% të BPP-së. Më gjerësisht, nëse, përveç dërgesave të parave të punëtorëve, marrim në konsideratë burime të tjera siç janë dërgesat e tjera personale, përfitimet e pensionit dhe të ardhurat nga puna e banorëve të Kosovës nga punë të përkohshme jashtë vendit, hisja në PBB tejkalon 20%. Sidoqoftë, shpërndarja e remitancave, të cilat dominojnë konsumin aktual, parandalon mundësinë që këto dërgesa a të bëhen një gjenerator i rritjes ekonomike shtesë dhe të përshpejtojnë zhvillimin e ardhshëm. Prandaj, forcimi i komponentës së investimit është i domosdoshëm dhe mund të konsiderohet si një burim i pashfrytëzuar.

1 Statistikat e migriminit



Literatura e emigrimit në Kosovë identifikon katër valë të emigrimit në 60 vitet e fundit.

Literatura për migrimin në Kosovë identifikon katër valë emigrimi në 60 vitet e fundit.

E para ndodhi në fund të viteve 1960 dhe në fillim të viteve 1970 kur djem të rinj të pakualifikuar, kryesisht nga zonat rurale dhe me kualifikime më të ulëta, emigruan në Gjermani dhe Zvicër. Largimet paten shkurtazi një rënie në vitet 1970 kur u krijuan vende të reja pune në institucionet e administratës publike dhe ndërmarrjet shoqërore..

Vala e dytë ndodhi në periudhën nga 1989 deri në 1997 kur autonomia e Kosovës u shfuqizua dhe njerëzit u larguan nga administrata dhe ndërmarrjet shoqërore. Banorët e arsimuar më mirë të Kosovës emigruan në vendet e Evropës Perëndimore për të gjetur punë ose për të shmangur mobilizimin.

Periudha e tretë ndodhi nga viti 1998 deri në 1999 kur pothuajse një milion njerëz në Kosovë u zhvendosën për shkak të luftës. Ky trend u përmbys menjëherë pas konfliktit kur pati një kthim masiv të popullsisë së zhvendosur.

Pas vitit 1999, emigrimi ndodhi në tri valë: 1) migrimi me qëllim të bashkimit familjar; 2) migrimi i paligjshëm i të rinjve të pakualifikuar dhe pamjaftueshëm të arsimuar; dhe 3) migrimi i ligjshëm i individëve shumë të kualifikuar dhe me arsim të lartë përmes studimeve ose aranzhimeve të punës.

Sipas të dhënave të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) nga Anketa e Remitancave të Kosovës, më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të emigrantëve u larguan nga Kosova në valën e fundit. Pjesa e dytë më e madhe ishte gjatë valës së dytë të emigracionit në fund të viteve 1980 dhe gjatë viteve 1990.

Shpërndarja e emigrantëve ndër valët e emigrimit

| Vala e emigrimit | Përqindja e emigrantëve |
|------------------|-------------------------|
| I. Pre-1989 | 8.8 % |
| II 1989-1997 | 25 % |
| III. 1998-1999 | 12.6 % |
| IV. Post 1999 | 53.6 % |

Burimi: Studimi i Remitancave në Kosovë 2012, UNDP, 2012, faqe. 26.

2
Programi i Kombeve të
Bashkuara për Zhvillim
(2012). Studimi i
Remitencave në Kosovë
2012. UNDP.

Pasqyra e destinacioneve tregon vazhdimin e trendit nga periudha paraardhëse. Kjo tregon se struktura e diasporës e krijuar më parë kryesisht formon trendin e sotëm. Prandaj, nuk është për t'u habitur që Gjermania dhe Zvicra janë të parat në listën e destinacioneve të emigrimit.

Një numër i konsiderueshëm i emigrantëve gjithashtu vazhdojnë jetën e tyre në Itali dhe Austri, dhe grupet e tjera më të mëdha shkojnë në Francë dhe Shtetet e Bashkuara.

Shtetet destinacion të emigrantëve


| SHTETET NIKOQIRE TË EMIGRANTËVE | PËRQINDJA E EMIGRANTËVE | SHTETET NIKOQIRE TË EMIGRANTËVE | PËRQINDJA E EMIGRANTËVE | SHTETET NIKOQIRE TË EMIGRANTËVE | PËRQINDJA E EMIGRANTËVE |
|---------------------------------|-------------------------|---------------------------------|-------------------------|--|-------------------------|
| Afganistani | 0.6 % | Danimarka | 0.2 % | Holanda | 0.3 % |
| Arabia Saudite | 0.2 % | Finlanda | 0.9 % | Norvegjia | 1.2 % |
| Australia | 0.6 % | Franca | 4.2 % | Rusia | 0.2 % |
| Austria | 6.8 % | Gjermania | 31.3 % | Slovenia | 1.2 % |
| Belgjika | 3.9 % | Islanda | 0.2 % | Suedia | 2.6 % |
| Bosnia dhe Herzegovina | 0.8 % | Iraku | 0.2 % | Zvicra | 27.9 % |
| Kanada | 1.2 % | Irlanda | 0.2 % | Mbretëria e Bashkuar | 2.8 % |
| Republika Çeke | 0.3 % | Italia | 7.1 % | Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) | 4.8 % |
| Kroacia | 0.2 % | Mali i Zi | 0.3 % | | |

Burimi: Përshtatur nga Studimi i Remitencave në Kosovë 2012.



Struktura arsimore e kontigjentit të emigrimit ka qenë mjaft e qëndrueshme në tri dekadat e fundit. Pjesëmarrësit më të rëndësishëm në kontingjent ishin njerëzit me arsim të mesëm të lartë, të ndjekur nga arsimi fillor dhe arsimi universitar. Më shumë se 80 përqind e emigrantëve kishin arsim të mesëm ose universitar. Ndryshimi në këtë strukturë krahasuar me vitet para vitit 1989 ishte kryesisht i lidhur me trendin e arsimit më intensiv në Kosovë. Në çdo rast, struktura ishte e pafavorshme nga pikëpamja e komunitetit shoqëror. Megjithatë, largimi i një fuqie punëtore me aftësi të ulëta mund të ketë efekte pozitive. Duke kaluar në ekonomi më të përparuara me nivele më të larta të produktivitetit, individë të tillë sigurojnë një standard më të mirë jetese për veten dhe familjet e tyre. Largimi mbizotërues i njerëzve shumë të kualifikuar ndikon negativisht në ofrimin e fuqisë punëtore, atraktivitetin e Kosovës për investitorë të huaj, produktivitetin, inovacionin, etj.

Niveli i arsimit të emigrantëve sipas valëve të emigrimit



Statistikat zyrtare për migrim të hartuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ofrojnë të dhëna si për largimet e popullësisë ashtu edhe për hyrjet. Bilanci i këtyre lëvizjeve është vazhdimisht negativ, por me një ndryshueshmëri shumë të theksuar të shumave absolute. Pas pikut të vitit 2015, ku mbi 74,000 njerëz emigruan dhe vetëm një e katërta e këtij numri u regjistrua si emigrantë, pasuan dy vjet zbutje të kësaj tendence. Pas kësaj, fluksi i emigracionit u intensifikua përsëri me bilanc negativ prej mbi 21,000 persona dhe pothuajse 29,000 respektivisht në 2018 dhe 2019. Në çdo rast, në periudhën 2015-2019 territori i Kosovës regjistroi një bilanc negativ migrimi prej mbi 120,000 njerëz.

Burimi: Studimi i Remitencave në Kosovë, 2012.

Migrimi ndërkombëtar në Kosovë

| | Imigrimi | Emigrimi | Bilanci i migrimit ndërkombëtar |
|------|----------|----------|---------------------------------|
| 2015 | 18862 | 74434 | -55572 |
| 2016 | 5492 | 14432 | -8940 |
| 2017 | 5832 | 11263 | -5431 |
| 2018 | 6762 | 28164 | -21402 |
| 2019 | 6066 | 34911 | -28845 |

Burimi: [Databaza e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Parashikimi i Popullsisë së Kosovës 2017-2061](#)
dhe [Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës, 2015, Agjencia e Statistikave të Kosovës](#)

Azilkërkuesit në BE, nga vendi i origjinës


| VENDI | 2015 |
|---------------|------------------|
| Siri | 368,355 |
| Afganistan | 181,425 |
| Irak | 124,970 |
| Kosovë | 72,480 |
| Shqipëri | 67,950 |
| Pakistan | 48,015 |
| Eritre | 34,130 |
| Nigeri | 31,245 |
| Serbi | 30,065 |
| Iran | 26,575 |
| Totali | 1,323,485 |

Largimi masiv i popullsisë gjatë vitit 2015 konfirmohet po ashtu edhe nga të dhënat e Eurostat mbi azilkërkuesit, ku sipas të cilave Kosova ishte në vendin e katër në atë vit, pas Sirisë, Afganistanit dhe Irakut.

Burimi: Databaza nga Eurostat

Azilkërkuesit nga Kosova

Numri i azilkërkuesve nga Kosova në vendet e BE



Largimi i përafërisht 75,000 qytetarëve nga një komunitet prej 1,7 mlionësh paraqet një shok demografik të rëndësishëm. Kjo paraqet pothuajse 4,5% të populates së përgjithshme. Duke e pasur parasysh që individët vendosin të zhvendosen në një moshë më të re, është e qartë që ky numër në mënyrë të ndjeshme prekë strukturën e moshës së komunitetit që mbetet.

Burimi: Databaza e Eurostat

2 Natyra ekonomike e migriminit



Edhe brenda Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, Kosova ishte shpallur zonë e pazhvilluar. Përpjekjet për të përmirësuar statusin ekonomik të kësaj zone dështuan me rënien e këtij shteti. Konfliktet e viteve 1990 që kapluan të gjithë rajonin vetëm e varfëruan më tej popullsinë. Megjithëse është bërë njëfarë progresi, prapambetja ekonomike e Kosovës është e dukshme jo vetëm në krahasim me vendet e Evropës Perëndimore, por edhe në krahasim me vendet e rajonit. Sipas një studimi të kryer së bashku nga Banka Botërore dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, në vitin 2017, 18% e popullsisë së Kosovës jetonte nën kufirin e varfërisë, e cila ishte vetëm 1.85 € për të rritur në ditë, dhe 5.1% e popullsisë jetonte nën kufirin ekstrem të varfërisë, 1,31 € për të rritur në ditë³. Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore⁴, shkalla e përgjithshme e papunësisë është 30%, dhe shkalla më e lartë ishte tek rinia e moshës 15 deri në 24, duke shkuar në 55.4%.

Papunësia e lartë alarmante e kombinuar me pagat e ulëta mesatare nuk i inkurajojnë të rinjtë të bëhen të pavarur ose të krijojnë familje, por përkundrazi të mendojnë se ku mund ta ndërtojnë të ardhmen e tyre. Është e qartë se të rinjtë nuk zgjedhin vendin ku do të shkojnë në përputhje me shkallën e papunësisë, pagën mesatare ose PBB-në. Më shpesh ata ndjekin “shtigje të shkelura”; por ata krahasojnë treguesit bazë makroekonomikë me ekuivalentët e tyre në vendet e zhvilluara. Kjo konfirmon se një perspektivë e dobët ekonomike është e rëndësishme dhe mbështet supozimin themelor që shtytësit më të rëndësishëm të migrimit, veçanërisht të të rinjve, janë faktorët ekonomikë.

Për rininë, e cila zakonisht është pjesa më e lëvizshme e popullsisë, kushtet e tregut të punës janë një nga faktorët kryesorë të shtytjes. Papunësia në këtë pjesë të popullsisë është jashtëzakonisht e madhe në Kosovë, ku afërsisht gjysma e të rinjve që janë në tregun e punës nuk kanë asnjë shans për të gjetur ndonjë punë pas mbarimit të shkollës. Një krahasim me vendet e tjera sugjeron që kjo normë në Kosovë është shumë herë më e lartë. Më saktësisht, jo vetëm në krahasim me vendet e zhvilluara por edhe në krahasim me vendet e tjera në rajon, Kosova ka një rekord të dobët sipas këtij indikator. Ky është padyshim një indikator i situatës jashtëzakonisht të vështirë për të rinjtë, të cilët, së bashku me faktorë shtesë si korrupsioni, cilësia e kujdesit shëndetësor, liritë politike dhe siguria ligjore, krijojnë presion të fortë mbi këtë pjesë të popullsisë për ta drejtuar atë drejt emigrimit.

3
Banka Botërore dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019). Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës, Banka Botërore dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. <https://ask.rks-gov.net/media/4901/poverty-statistics-2012-2017.pdf>.

4
Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019). Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë, 2018. Agjencia e Statistikave të Kosovës. <https://ask.rks-gov.net/media/5026/labour-force-survey-2018.pdf>.

Shkalla e papunësisë së rinisë në vitin 2018

| Vendet e emigrimit | | Destinacioni | |
|------------------------|--------|--------------|--------|
| Kosova | 55.4 % | Sllovenia | 8.8 % |
| Bosnja dhe Hercegovina | 38.8 % | Norvegjia | 9.7 % |
| Serbia | 29.7 % | Zvicra | 7.9 % |
| Bullgaria | 12.7 % | ShBA | 8.6 % |
| Macedonia e Veriut | 45.4 % | Franca | 20.8 % |
| Rumania | 16.2 % | Italia | 32.2 % |
| Hungaria | 10.7 % | Gjermania | 5.1 % |
| Mali i Zi | 29.4 % | Austria | 9.4 % |
| Shqipëria | 31.9 % | Suedia | 16.8 % |

Burimi: Institutet Kombëtare të Statistikave dhe Eurostati

Të hyrat mesatare (net) në 2018 (euro)

| Vendet e emigrimit | | Destinacioni | |
|------------------------|-------|--------------|---------|
| Kosova | € 409 | Sllovenia | € 4,502 |
| Bosnja dhe Hercegovina | € 449 | Norvegjia | € 2,640 |
| Serbia | € 420 | Zvicra | € 2,724 |
| Bullgaria | € 508 | ShBA | € 3,754 |
| Macedonia e Veriut | € 395 | Franca | € 2,948 |
| Rumania | € 579 | Italia | € 2,336 |
| Hungaria | € 688 | Gjermania | € 1,778 |
| Mali i Zi | € 511 | Austria | € 1,075 |
| Shqipëria | € 365 | Suedia | € 2,546 |

Shkalla e lartë e papunësisë e kombinuar me paga të ulëta edhe kur gjendet një punë, sigurisht që nuk ofron perspektivën e pritur. Megjithëse të dhënat e pagave ofrojnë të dhëna të kufizuara për standardet e jetesës dhe cilësinë e jetës, duhet theksuar se paga mesatare në Kosovë është rreth shtatë herë më e ulët se në Gjermani dhe Austri, ndërsa është nëntë herë më e ulët se në Norvegji dhe 11 herë më e ulët se në Zvicërr.

Burimi: Institutet Kombëtare të Statistikave dhe Eurostati

PBBja për frymë në 2018 (euro)

| Vendet e emigrimit | | Destinacioni | |
|------------------------|----------|--------------|----------|
| Kosova | € 3,753 | Sllovenia | € 22,146 |
| Bosnja dhe Hercegovina | € 5,143 | Norvegjia | € 69,051 |
| Serbia | € 8,015 | Zvicra | € 70,413 |
| Bullgaria | € 6,136 | ShBA | € 53,392 |
| Macedonia e Veriut | € 5,153 | Franca | € 36,480 |
| Rumania | € 10,475 | Italia | € 29,212 |
| Hungaria | € 13,672 | Gjermania | € 40,501 |
| Mali i Zi | € 7,498 | Austria | € 43,431 |
| Shqipëria | € 4,475 | Suedia | € 45,974 |

Kur shikohet PBB-ja për frymë si një masë e standardit jetësor të popullsisë së një vendi, ajo është shumë herë më e lartë në vendet e destinacionit: në Gjermani gati 11 herë, në Austri dhe Suedi rreth 12 herë, në Norvegji 18 dhe në Zvicër 19 herë më e lartë se në Kosovë.

Burimi: FMN, Baza e të dhënave për perspektivën ekonomike botërore, tetor 2020.

Studimi mbi rininë në Kosovë 2018/19 i Fondacionit FES, i cili i analizon të dhënat nga një hulumtim në terren nga një projekt më i gjërë rajonal “Rinia në Europën Juglindore”, ofron informata shtesë që konfirmojnë arsyet ekonomike si shkakun kryesor të emigrimit⁵.

Sipas këtij hulumtimi, papunësia e të rinjve në Kosovë është një problem i madh, dhe ndikimi i saj është shumëdimensional, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se Kosova ka popullsinë më të re në botë. Njohjet dhe lidhjet me njerëzit në pushtet konsiderohen nga të rinjtë si shumë të rëndësishme për gjetjen e një pune në 54 deri në 58 përqind të rasteve, ndërsa siguria e punës është faktori kryesor që të rinjtë në Kosovë konsiderojnë kur zgjedhin një vend pune. Kjo nënkupton shqetësim të madh në lidhje me të drejtat e punonjësve në lidhje me punën e papaguar jashtë orarit, problemet me shumatat e pagave dhe statusin e punësimit. Prandaj, nuk është për t'u habitur që 70 përqind e të rinjve dëshirojnë të punojnë në sektorin publik, dhe vetëm 23 përqind në sektorin privat.

Më shumë se gjysma e të rinjve në Kosovë janë në një situatë ku duhet të bëjnë punë që nuk janë brenda profesionit të tyre. Kjo tregon një mospërputhje të lartë midis sistemit arsimor dhe nevojave të tregut të punës. Vetëm 23 përqind e të anketuarve janë të kënaqur me cilësinë e arsimit dhe ky është një nga numrat më të ulët në të gjithë rajonin. Për më tepër, Kosova është i vetmi vend ku niveli i kënaqshmërisë me cilësinë e arsimit është përkeqësuar me kalimin e kohës. Më shumë se 56 përqind e


të rinjve përgjithësisht pajtohen se ka raste të ryshfetit në universitete në Kosovë. Kur u pyetën nëse dëshironin të emigronin nga vendi, gati gjysma e të anketuarve në këtë sondazh shprehën dëshirën të largoheshin nga vendi: 18 përqind thanë se kishin një dëshirë shumë të fortë, 17 përqind kishin një dëshirë të fortë dhe 12 përqind kishin një dëshirë të moderuar për të emigruar. Rreth një e treta e të anketuarve që planifikonin të largohen nga vendi nuk kishin ndërmend të ktheheshin kurrë në Kosovë. Si destinacioni më i preferuar, të rinjtë nga Kosova deklaruan ekskluzivisht vendet e zhvilluara, si më poshtë: 25 përqind Zvicrra, 24 përqind Gjermania, e ndjekur nga Franca dhe Shtetet e Bashkuara me tetë përqind secila, ndërsa Austria dhe Suedia ishin me rreth pesë përqind të të anketuarve.

5
Rrumbullaku, Oltion
(2019). Studimi për
Rininë - Kosovë 2018/19.
Friedrich-Ebert-Stiftung.
[https://library.fes.de/pdf-
files/id-moe/15264.pdf](https://library.fes.de/pdf-files/id-moe/15264.pdf).

Motivet për emigrim ishin tërësisht të dominuara nga faktorët ekonomik. Në mesin e tyre, më të theksuarit ishin: përmirësimi i kushteve të jetesës (48%), mundësi më të mira punësimit (15%), si dhe paga më të larta (5%).



Motivet për emigrim të popullatës nga Kosova (përqindja)



- Përmirësimi i standardit të jetesës
- Mundësi më të mira punësimi
- Të përjetoj një kulturë ndryshe
- Arsye tjera
- Arsim më i mirë
- Rroga më të larta
- Të jem afër njerëzve të dashur

Burimi: Studimi për Rininë - Kosovë
2018/19, Friedrich-Ebert-Stiftung, 2019.

Krahas këtij studimi, të dhëna interesante për migrimin dhe vendet e preferuara ofrohen edhe në Anketën e Migrimit të bërë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, që analizon periudhën nga viti 1969 deri në 2010⁶. Në këtë kontekst, shihet që përgjatë gjithë periudhave kohore arsyet kryesore nuk kanë qenë vetëm ekonomike por po ashtu edhe sociale dhe politike. Nga përgjigjet e ofruara në pyetjet se pse kanë emigruar familjarët e tyre, lidhjet e fuqishme familjare të popullsisë së Kosovës ishin arsyet kryesore për emigrim (zakonisht për martesë apo bashkim familjar) për gjysmën e të anketurëve. Arsyet ekonomike (në rend të parë punësimi) ishin motivi për emigrim për pothuajse 40% të njerzëve, përderisa emigrimi për shkak të luftës ishte arsye emigrim për rreth 8% të njerzve. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, mbi 35% e popullsisë së përgjithshme emigroj në Gjermani, ndjeku nga 23% në Zvicërr dhe mbi 7% në Itali. Numra të konsiderueshëm të njerzëve emigruan edhe në Suedi dhe ShBA.

6

Agjencia e Statistikave të Kosovës (2014). Migrimi Kosovar, Agjencia e Statistikave të Kosovës. <https://ask.rks-gov.net/media/1380/kosovan-migration-2014.pdf>.

3 Kostoja e Emigrimit të Rinisë



Efektet e lëvizjeve të popullsisë janë të ndryshme në varësi të perspektivës së vendit të vëzhguar dhe mund të jenë pozitive dhe negative.

Kur bëhet fjalë për emigrimin e të rinjve dhe të ashtuquajturën “ikje e trurit”, ne së pari konsiderojmë sasinë e investimeve në arsimimin e tyre nga e gjithë shoqëria. Investimi në arsim dhe trajnim humbet përmes emigrimit pasi kapitali i investuar në arsim dhe trajnim nuk kthehet në vendin e lindjes përmes të ardhurave që fitojnë emigrantët.

Përveç kësaj, largimi i një të force punëtore shumë të arsimuar dhe me aftësi të larta, redukton aftësinë e vendit për t'u zhvilluar, sepse inovatorët potencial që janë në kërkim të krijimit të produkteve të reja, tregjeve të reja apo rritje të PBB-së janë duke u larguar. Gjithashtu ka humbje të vlerës së shtuar për punonjës potencial, të përcjellura edhe me ulje të konsumit të përgjithshëm e që ndikojnë drejtpërdrejt në ulje të BPV. Individët që largohen nga vendi nuk krijojnë ndonjë vlerë të shtuar dhe nuk shpenzojnë brenda vendit, gjë që ndikon negativisht në potencialin e aktivitetit ekonomik të prodhuesve vendor. Ata nuk pagujnë as taksa në vendin e tyre amë, që do të thotë se shteti humb të hyra që do të mund t'i shfrytëzonte për përmirësimin e arsimit apo shërbimeve të tjera.

Emigrimi ka edhe efekte pozitive, të cilat reflektohen kryesisht përmes ardhjes direkte të të hollave nga jashtë përmes remitencave. Roli i tyre kryesor është që ruajnë stabilitetin buxhetor; mirëpo do të ishte shumë më e dobishme nëse këto të hyra do të shfrytëzoheshin në prodhim në vend të konsumit personal. Po ashtu, ka gjithmonë shpresë dhe mundësi që personat që janë larguar nga vendi të kthehen në një moment të caktuar, e të cilët do të sillnin me vete përvojën e konsiderueshme dhe njohuritë profesionale, e po ashtu edhe kapitalin që do të mund ta investonin në vendin e tyre, të cilat nuk do t'i kishin fituar asnjëherë, nëse nuk do të ishin larguar nga vendi.



Cili është çmimi i përgjithshëm i shkollimit të përfunduar në vitim 2018?

3.1

Në përpjekje për të gjetur përgjigje në këtë pyetje, ne kemi filluar duke parë të dhënat e shpenzimeve qeveritare sipas klasifikimeve funksionale (COFOG)⁷. Në përputhje me këtë klasifikim, të gjitha shpenzimet qeveritare nga burtimet e brendshme apo të jashtme janë klasifikuar në 10 grupe, një ndër të cilët është arsimiti.

METODOLOGJIA E KALKULIMIT

Shpenzimet qeveritare për arsim përfshijnë shërbimet e ofruara për nxënës dhe studentë individual dhe shpenzimet e ofruara në baza kolektive. Ndarja e shpenzimet bazohet në kategoritë e Standardeve Ndërkombëtare të Klasifikimit për Arsim të vitit 1997 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë. Të dhënat për këto shpenzime publikohen rregullisht nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Ministria e Financave dhe janë të qasshme që nga viti 2008. Meqenëse të diplomuarit mesatar kanë filluar shkollimin në vitin shkollor 2000/2001, ka qenë e nevojshme që të përcaktohen shpenzimet vjetore për arsim për secilin vit veç e veç për periudhën e vëzhguar.

Meqenëse të dhënat e institucioneve përgjegjëse për këto shpenzime janë të qasshme për një periudhë më të shkurtë kohore se sa periudha e vëzhguar, atëherë është kërkuar që të bëhet një kombinim i këtyre të dhënave me të dhëna të statistikave të arsimit, që janë të qasshme për të gjithë periudhën e vëzhguar, ashtu që të përlogariten të dhënat e shpenzimeve qeveritare për periudhën e munguar.

7
Eurostat (2019). Manuali mbi Burimet dhe Metodatat e Përpilimit të Statistikave të KFQ (Klasifikimit të Funksioneve të Qeverisë)- (Manual on Sources and Methods for the Compilation of COFOG (Classification of Functions of Government) Statistics), Eurostat, Luksmburg.
<https://bit.ly/3wRnLix>

8.
Kombet e Bashkuara (2018). Klasifikimi I Konsumit Individual Sipas Qëllimit (COICOP). 2018. Kombet e Bashkuara. E qasshme në:
<https://bit.ly/32gt5Of>

Paralelisht, të dhënat për numrin e nxënësve dhe studentëve për çdo vit në periudhën e specifikuar janë marrë me qëllim të kalkulimit të alokimit për njësinë e vëzhguar.

Pasi që është përcaktuar shuma e përgjithshme vjetore e shpenzimeve për arsim në periudhën 2001-2018, vlerat e fituara janë zbritur ashtu që të gjitha shpenzimet për këtë periudhë 18 vjeçare janë ulur në vlerën e sotme monetare.

Seti i të dhënave të krijuara sipas kësaj metode janë përdorë për të vlerësuar shpenzimet e shkollimit për nivelet e arsimit për të ju përgjigjur pyetjes se sa është buxheti mesatar i qeverisë dhe ekonomive familjare që kanë shpenzuar për arsimin primar, sekondar dhe të lartë për një individ që ka përfunduar disa këto niveleve të shkollimit në vitin 2018? Duhet theksuar që kjo është një mesatare e cila nuk do të duhet të ketë ndryshime të dukshme në arsimin primar e sekondar ndërsa ndryshimi nga mesatarja rritet dukshëm për studimet akademike, ku është një indikator sitentik i shpenzimeve të shkollimit ngase përmban një pjesë të secilimit nivel akademik. Vlerësime më precize mund të bëhen për fakultete apo kolegje individuale, profike të specializuara apo nivelin post-diplomik, e të cilat mund të jenë subjekt i ndonjë hulumtimi në të ardhmen.

REZULTATET

Rezultatet e fituara nga aplikimi i metodologjisë së përmendur më lart tregojnë që rreth €4,700 janë investuar në arsimimin e një banori të Kosovës që ka përfunduar nëntë vite të shkollimit privmar në vitin 2018. Shpenzimet për shkollimin e mesëm që ka zgjatë tri vite dhe ka përfunduar në vitin 2018 (duke përfshirë shkollimin primar) kanë qenë rreth €6,100, ndërsa për një student të diplomuar që nga fillimi i shkollimit primar, shkollimit të mesëm e deri në përfundimin e studimeve akademike që kanë zgjatë mesatarisht pesë vite dhe ka përfunduar në vitin 2018, janë investuar rreth €9,700.



Burimi: Kalkulimet e autorit

Megjithëse përdorimi i mesatare në analiza të të dhënave mund të fsheh pasqyrën apo të interpretohet në mënyra të ndryshme, ne theksojmë që këto shuma përfaqësojnë hapin e parë drejt kuantifikimit të efekteve të një bilanci negativ të migrimit. Numri i banorëve me diploma akademike është heterogjen në kuptim të shpenzimeve për fakultete individuale dhe kohëzgjatje të studimeve; mirëpo nga perspektiva makroekonomike, një devijim i një shume më precizve nga ajo e arritur këtu, nuk do të qonte në ndryshime të mëdha të përfundimeve. Gjithashtu, duke vëzhguar këto shpenzime sipas viteve, është vërejtur një stabilitet i fuqishëm në këtë seri të të dhënave, që mundëson marrjen parasysh edhe të personave që kanë përfunduar shkollimin para vitit 2018.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në periudhën 2015-2019, dalja mesatare vjetore e popullsisë nga Kosova ka qenë rreth 33,600 persona. Struktura e detajuar e arsimimit të këtij kontigjeni nuk ekziston apo së paku nuk është e qasshme për publikun. Në mënyrë që të vlerësohet shpenzimi i shkollimit të këtij numri personash si hap i parë, do të duhej të largoheshin nga personat e moshës 5 vjeçare apo më të vegjël dhe të korrigjohen të dhënat për grumbullin e personave që nuk kanë përfunduar shkollimin primar apo sekondar. Struktura e moshës së popullsisë është marrë si kornizë për këtë vlerësim, është ndryshuar në përputhje me hipotezën që një numër i fëmijëve në emigrim është për gjysëm më i ulët se ndarja e popullsisë. Sa i përket strukturës arsimore të kontingjentit të përmirësuar migruës, ne kemi përdorë strukturën arsimore të emigrantëve si pikë fillestare sipas studimit për remitencat nga UNDP në Kosovë.

Qasja ndaj shpenzimeve individuale në këtë punim ka mundësuar krijimin e një skenari alternativ. Rrjedhimisht, ne kemi analizuar skenarin 2, që bazohet në hipotezën që të gjitha nivelet e arsimimit kanë një përfaqësim të barabartë në kontigjenin e përgjithshëm të emigrimit.

Rezultatet tregojnë që shpenzimi i përgjithshëm për arsimimin e personave që po lëshojnë Kosovën për një vit, varësisht nga struktura arsimore, lëviz nga mbi €180 milion deri në gati €205 milion.

Shpenzimet në arsim në Kosovë sipas strukturës së përzgjedhur arsimore dhe e ndërlidhur me daljen e përgjithshme të popullsisë (në miliona euro)

| | Skenari 1 | Skenari 2 |
|------------------------|--------------------|--------------------|
| Arsimi Primar | 24.3 mil € | 47.8 mil € |
| Arsimi i mesëm i lartë | 122.6 mil € | 57.9 mil € |
| Arsimi terciar | 34.4 mil € | 99.2 mil € |
| PËRGJITHSHËM | 181.2 mil € | 204.9 mil € |

Source: Author's calculation

Strukturat gjithëpërfshirëse dhe plotësisht të besueshme dhe statistikat e atyre që janë larguar apo atyre që kthehen nuk ekzistojnë. Nuk dihet nëse ata janë punonjës sezonal, pensionistë të jashtëm, migrantë të përkohshëm të larguar për qëllime trajnimi apo arsimimi etj. Kjo e ndërlikon dukshëm kauntifikimin e efektit përfundimtar të migrimit. Nëse shpenzimet individuale do të aplikoheshin në largimin neto të popullsisë nga Kosova, shpenzimet e arsimimit do të varironin prej €133 milion deri në €151 milion, varësisht nga struktura e supozuar arsimore. Megjithatë, ne besojmë që efekti i largimit të përgjithshëm duhet të merret shumë seriozisht, sepse, pa marrë parasysh natyrën aktualisht të përkohshme të një numri të këtyre largimeve, ato paraqesin një hap më afër emigrimit të përhershëm, veçanërisht nëse merren parasysh politikat dhe masat e vendeve të zhvilluara.

Vendet e zhvilluara me mungesë të fuqisë punëtore hartojnë politika të ndryshme për të tërhequr popullsinë në moshë pune. Disa vende të Bashkimit Evropian kanë miratuar disa masa lehtësuese për të zgjatur qëndrimin e punonjësve nga vendet e botës së tretë. Qëllimi i tyre është që kompenzojnë mungesën e punonjësve të aftë për punë në disa vende. Për shembull, Austria ka ndryshuar Ligjin për Vendosje dhe Rezidencë në vitin 2017 me qëllim që të lehtësojë qasjen në tregun e punës dhe integrimin në shoqëri për punonjës të aftë që vijnë nga vendet e Botës së Tretë. Estonia ka zhvilluar strategjinë “Të Punosh në Estoni” me qëllim që të tërheq punonjës me kualifike të larta. Gjermani ka ndërmarrë masa që të ofrojë

informacione shtesë për migrantët dhe të organizojë trajnime profesionale e mentorim, me qëllim që të lehtësojë qasjen në tregun e punës dhe punësimin afatgjatë për punonjës që kanë migruar. Ligji për Punonjësit e Aftë është miratuar gjithashtu, dhe ka hyrë në fuqi me 1 mars 2020 e që mundëson imigrimin në Gjermani për qëllime të punësimit. Qëllimi i tij është që të lehtësojë ardhjen e ekspertëve nga vendet që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian.

Vendet e Bashkimit Evropian po ashtu kanë përsheptuar procedurat për pranimin e studentëve nga vendet e tjera. Masa bazike është që lehtësojë qasjen e studentëve në tregun e punës gjatë kohës së studimeve dhe pas diplomimit. Po ashtu, procedurat administrative që ndërlidhen me shkuarjen për studime në Bashkimin Evropian janë lehtësuar, e gjithashtu është mundësuar edhe qëndrimi më i gjatë pas diplomimit. Në disa raste, vendet e Bashkimit Evropian synojnë një vend specifik të Botës së Tretë dhe krijojnë politika specifike që tërheqin studentë dhe të rinj nga ai shtet. Me qëllim të tërheqjes së studentëve që duan të studiojnë dhe punojnë paralelisht, Austria ka rritur numrin e orëve të punës për student deri në 20 orë në javë. Gjithashtu, pas diplomimit, Austria u mundëson studentëve të huaj që të qëndrojnë edhe për një vit ashtu që të mund të gjejnë punë. Këto masa inkurajojnë të rinjtë dhe shtetasit e vendeve të treta me potencial punësimi që të arsimohen apo të zhvillojnë karrierën bizneshore në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian.

Vendet e destimit të personave me arsimimin të lartë padiskutim që përfitojnë nga ardhja dhe përfshirja e tyre në sistemin ekonomik e shoqëror. “Përfitimi” i tyre është dukshëm më i madh se sa “humbja” që pëson vendi i origjinës për shkak të largimit të tyre. Përveç largimit të problemit të mungesës së fuqisë punëtore, vendet në zhvillim shpenzojnë shumë më shumë për shërbime të shkollimit edhe nga shteti por edhe ekonomitë shtëpiake, e kjo duhet marrë parasysh. Sipas të dhënave të Eurostat për vitin 2015, alokimi vjetor i buxhetit të shtetit dhe ekonomive shtëpiake për nivelin e mesëm të lartë ka qenë rreth €11,000 për nxënës në Francë dhe rreth €10,500 në Gjermani, krahasuar me vetëm rreth €630 euro në Kosovë. Ky dallim është shumë më i theksuar në arsimin terciar, ku në krahasim me alokimin e rreth €790 për student në vit në Kosovë, Mbretëria e Bashkuar shpenzon 27 herë më shumë, Suedia shpenzon 21 herë më shumë, Austria, Franca dhe Gjermani shpenzojnë afërsisht 17 herë më shumë, etj.

Shpenzimet e përgjithshme vjetore për shërbime të arsimit për vitin 2015 për student (në euro)

| Shpenzimet e përgjithshme vjetore për shërbime të arsimit për vitin 2015 për student (në euro) | | |
|--|----------------|------------------------|
| | Arsimi terciar | Arsimi i mesëm i lartë |
|  Kosovë | € 790 | € 632 |
|  Gjermani | € 13,137 | € 10,457 |
|  Francë | € 13,333 | € 10,900 |
|  Austri | € 14,074 | € 9,410 |
|  Suedi | € 17,011 | € 9,100 |
|  Mbretëria e Bashkuar | € 21,682 | € 8,796 |

Tarifat e shkollimit bëhen përgjatë një periudhe të gjatë kohore varësisht nga vitet që kërkohen për të përfunduar shkollimin. Për më shumë, largimi i një numri të caktuar të njerëzve jashtë vendit ka ndikime të menjëhershme në ekonominë e vendit dhe është një gjenerues i humbur i profitit në të ardhmen, e që realisht është vetë definimi i mundësisë së shpenzimeve. Megjithëse ky shpenzim ndërlidhet me vendimet e individëve, në analizën tonë kjo i atribuohet të gjithë shoqërisë. Meqenëse do tua lëmë demografëve e sociologëve që të përshkruajnë efektet e migrimit në vjetërsimin e popullsisë dhe zhvillimin e përgjithshëm shoqëror, fokusi i këtij punimi mbetet në identifikimin e shkallës së ndikimit në komponentën ekonomike të progresit shoqëror. Për këtë qëllim, ne e kemi lidhur numrin e njerëzve që kanë lëshuar Kosovën mesatarisht brenda vitit me BPV si një matës i aktivitetit ekonomik të një vendi.

Burimi: Statistikat e Financave në Arsim, databaza e Eurostat, kalkulimet e autorit


Cilat janë ndikimet në Aktivitetin Ekonomik

3.2

Sipas qasjes së prodhimit për matjen e aktivitetit ekonomik, BPD paraqet vlerën e shtuar të përgjithshme bruto të krijuar nga banorët brenda një viti. Vlera e shtuar bruto në fakt është vlera e përgjithshme e produkteve të prodhuara dhe shërbimeve të ofruara duke hequr konsumin e ndërmjetëm, që do të thotë veprimet, shpenzimet e prekshme dhe të paprekshme të shkaktuara gjatë prodhimit ose ofrimit të shërbimeve. Duke përdorur të dhënat zyrtare në vlerën e shtuar bruto të krijuar dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve, ne kemi kalkuluar indikatorin e produktivitetit, vlerën e shtuar bruto për punonjës.

Për shkak të specifikave të kalkulimit të prodhimeve bujqësore dhe metodologjisë së veçantë për matjen e aktivitetit ekonomik në biznesin e patundshmërive, që përfshinë konceptin e qerasë së imputuar, ne kemi përjashtuar këto dy aktivitete ekonomike nga vëzhgimi. Ky indikator ndryshon dukshëm nga një industri në tjetër përkatësisht nga rreth €3,500 në turizëm në mbi €45,000 në sektorin e minierave.

BPV për punonjës në vitin 2018, në euro



Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës

Për matjen humbjes së potencialit ekonomik të shkaktuar nga ulja e fuqisë punëtore, kemi përdorur daljen mesatare vjetore të njerëzve nga Kosova përkatësisht të 32,641 personave, të ndryshuar duke përshtatur strukturën e moshës, ngase jo të gjithë ata që janë larguar janë në moshë për punë. Hipoteza pasuese është që arsyeja kryesore e largimit të tyre – që të gjejnë një punë në profesionin e tyre ose çfarëdo pune – nuk qëndron; më specifikisht, që dinamikat e aktivitetit ekonomik kanë krijuar hapësirë për punësimin e tyre, dhe që gjatë vitit 2018 ata kanë pasur statusin e punonjësit. Duke përdorur shumën mesatare për punonjës, ne kemi arritur të nxjerrim koston e mundësisë në aspekt të humbjes së vlerës së shtuar bruto në Kosovë në shumën prej €418.9 milionësh për vit. Kjo ka pasur ndikim direkt negativ në nivelin e BPV potencial. Kur flasim rreth matjes së potencialit të BPV, duhet të kemi parasysh që ky është një koncept që matë nivelin maksimal të mundshëm të qëndrueshmërisë ekonomike të aktivitetit ekonomik duke përdorë të gjithë faktorët e prodhimit (punën, kapitalin dhe faktorin e përgjithshëm të prodhimitarisë). Në atë aspekt, kjo humbje nuk duhet të barazohet me humbjen e BPV-së reale që do të ndodhte në vitin 2018, ngase ishte shkaktuar nga largimi i njerëzve që kanë emigruar, kryesisht për shkak të pamundësisë për të gjetë një punë adekuate dhe për të marrë pjesë në krijimin e vlerës së shtuar. Me fjalë të tjera, përkundër disponueshmërisë së faktorëve të punës, megjithëse këta njerëz nuk do të punësoheshin në procesin e krijimit të BPV-së për vitin 2018, largimi i tyre paraqet humbje të përhershme të potencialit për ekonominë e Kosovës.

Duke pasë parasysh që largimi i këtij numri të njerëzve do të thotë ulje e konsumit të përgjithshëm, që është një ulje

e kërkesës, që në fund do të ulë nivelin e prodhimit dhe të shërbimeve, dhe kështu vlera e shtuar bruto apo BPV-në, arrijmë në një ndikim indirekt të emigrimit në aktivitetin ekonomik. Përdorimi i të dhënave në fitimin vjetor mesatar neto dhe numrin e personave të papunësuar që kanë emigruar, dhe pastaj marrëdhënien në mes të konsumit personal të përshtatur për balancin e jashtëm dhe BPV-në gjeneruar, ne e vlerësojmë këtë ndikim jodirekt në €84.6 million.

Përveç ndikimit direkt e indirekt në analizat makroekonomike, shpesh diskutohet edhe i ashtuquajtur i ndikimit indirekt. Meqenëse kjo nënkupton një numër të madh efektesh indirekte në rrjedhën ekonomike, kaunifikimi i plotë është gati i pamundur. Për shembull, popullsia e mbetur në vend nënkupton nevojën për më shumë mjek, profesorë, stomatolog, frizerë etj., që do të krijojnë kërkesë të shtuar agregate me pagat e tyre, e që do të jepte prapë hov prodhimit, duke e shndërruar këtë rrjedhë në një rreth vicioz të efekteve të pamundura për tu kuptuar dhe vlerësuar plotësisht. Largimi i këtij numri të njerëzve përfaqëson një kosto oportune edhe për shtetin, në aspekt të humbjeve të taksave që do të mblidheshin në të ardhmen. Kjo kryesisht i referohet taksave të në ardhura, kontributeve për sigurime sociale, taksën në vlerësn e shtuar e akcizat si të hyrat më të mëdha buxhetore. Duke përdorur të dhënat e qasshme në numrin e punonjësve, shpenzimet e përgjithshme personale, të hyrat e buxhetit dhe marrëdhëniet reciproke mes tyre, ne vlerësojmë që kjo shumë do të ishte rreth €51.8 milionë euro. Meqenëse po flasim për para që do të transferoheshin në konsum në të ardhmen përmes thesarit të shtetit (shërbime, investime kapitale, rritje të pagave e pensioneve) të cilat do të mund të jepnin edhe

ndikim stimulues në aktivitetet ekonomike, ne po ashtu e kemi klasifikuar këtë ndikim në grupin e efekteve të induktuara dhe duke përdorur shumëzuesin e vlerësuar fiskal, e kemi vlerësuar këtë ndikim në €15.5 million.

Rezultatet e nxjerra tregojnë që është e mundur në mënyrë direkte e indirekte që të parandalohen ikja vjetore e popullsisë duke i punësuar ata, një humbje vjetore në nivel të potencialit të BPV-së që është gjeneruar në shumën prej €519 milionë eurosh. Thënë thjesht, çdo individ i aftë për punë që emigron nga Kosova merr me vete mesatarsisht rreth €17,000 në vit në potencialin e ardhshëm vjetor të BPV-së, që do të mund të realizoheshin nëse rrjedha ekonomike do të mundësonte punësimin e tyre produktiv.



Efektet e migrimit në potencialin e
aktivitetit ekonomik në Kosovë, për
person (në euro)



Burimi: Kalkulimet e autorit

Përfitimet ekonomike të migrimit të popullsisë

3.3

Vlerësimi i efekteve të ciklit të migrimit varet nga perspektiva. Nga perspektiva e individit, migrimi ekonomik ka efekte pozitive sepse përfaqëson një lëvizje “të mirë”. Në nivel global, ndikimi pozitiv i proceseve të migrimit mbizotëron për shkak se rritë mirëqenien e përgjithshme, rritë efikasitetin dhe kontributin në rritjen globale. Një numër autorësh e krahasojnë këtë proces me proceshin e rrjedhs së pandërprerë të mallrave dhe kapitalit, duke theksuar rëndësinë e tij për ekonominë globale. Në anën tjetër, nëse shihet nga perspektiva e nivelit lokal apo kombëtar, emigrimi i popullsisë në moshë punë me aftësi dhe edukim të lartë, përfaqëson humbje të komunitetit.

Megjithatë, siç e kemi cekë tashmë, këto procese sjellin me vete ndikim të dyanshëm për ekonominë vendore. Ne jemi munduar ta kuantifikojmë efektin negativ ekonomik përmes kostos së arsimit të emigrantëve e po ashtu edhe koston oportune në aspekt të humbjes së përfitimeve të ardhshme si dhe kuantifikimin e ndikimit në BPV, mirëpo është i nevojshëm edhe një vlerësim i ndikimit pozitiv të këtyre proceseve.

Përfitimi më i konsiderueshëm i emigrimit janë remitencat. Këto janë fonde që transferohen nga emigrantët te familjet e tyre dhe persona të tjerë të afërm në vendin e origjinës. Ardhja e tyre përmirëson kualitetin e jetës së marrësve të remitencave, por e ndikon dukshëm edhe ekonominë e një vendi si Kosova.

Duke e marrë parasysh diasporën e madhe që ka, në aspekt të ndikimit të remitencave në BPV, Kosova është në majë të klasifikimit të vendeve evropiane, me rreth 12% të BPV-së që përbëhet nga remitencat. Thënë thjesht, nëse marrim për bazë burimet e tjera përveç remitencave të punonjësve, si transferet e tjera personale, pensionet e po ashtu edhe të ardhurat nga puna e banorëve të Kosovës që plotësojnë pozita të përkohshme të punës jashtë vendit, atëherë kontributi në BPV kalon 20%. Llogaritjet që përmes kanaleve jofromave si dhe paraveshkesh, një shumë më e madhe parash vjen në Kosovë por e cila nuk mund të regjistrohet zyrtarisht. Remitencat e punonjësve nga jashtë përbëjnë gati dyfish më shumë të hyra se sa eksporti i mallrave nga ekonomia e Kosovës që në vitin 2018 ka qenë €376.7 milionë.

Remitencat dhe të ardhurat e tjera personale dhe të hyrat nga jashtë vendit


| (në miliona €) | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|------------|--------------|-------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| Remitencat, | 584.3 | 492.5 | 516.4 | 573.4 | 622.3 | 665.5 | 691 | 759.2 | 800.6 |
| Transfere të tjera dhe të hyra nga puna | 359.7 | 447.8 | 509.7 | 564.4 | 491 | 474.4 | 473.3 | 491.9 | 549.9 |
| TOTAL | 944 | 940.3 | 1026 | 1137.8 | 1113.3 | 1139.9 | 1164.2 | 1251.1 | 1350.3 |

| (Përqindja e BPV) | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|---|-------------|-------------|-------------|-------------|-----------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Remitencat | 13.3 | 10.2 | 10.2 | 10.8 | 11.2 | 11.5 | 11.4 | 11.8 | 11.9 |
| Transfere të tjera dhe të hyra nga puna | 8.2 | 9.3 | 10.1 | 10.6 | 8.8 | 8.2 | 7.8 | 7.7 | 8.2 |
| TOTAL | 21.4 | 19.5 | 20.3 | 21.4 | 20 | 19.6 | 19.2 | 19.5 | 20.1 |

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, shumica e remitencave vijnë nga Gjermania dhe Zvicrra, e që përbëjnë rreth 61 për qind të shumës së përgjithshme të remitencave që vijnë në Kosovë. Ato përcillen nga vende të tjera të zhvilluara: Shhtetet e Bashkuara me rreth shtatë për qind, Italia me pak më pak se 5 për qind e pastaj nga Franca e Austria me rreth 4 për qind nga secila. Kjo strukturë e remitencave që vijnë është në përputhje të plotë edhe me listën e destinacioneve më tërheqëse për emigrantët që është prezantuar në fillim të këtij dokumenti.

Struktura e remitencave që vijnë sipas vendit të origjinës (në përqindje)




Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Të hyrat e larta që vijnë nga jashtë vendit kanë një rol ndikim të konsiderueshëm makroekonomik ngase ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e bilancit të deficitit. Duke ju falënderuar këtyre të hyrave, një pjesë e ekonomisë vendore mbahet gjatë duke mundësuar kështu konsumin vendosur përpara potencial real të brendshëm dhe fuqinë e konsumatorit të krijuar ekskluzivisht nga burimet e brendshme. Një anketë e realizuar nga UNDP ka treguar që remitencat përbëjnë 20.1 për qind të të ardhurave të përgjithshme për familjet që marrin nga ky burim të ardhurash, e që përbënë burimin më të madh të të ardhurave pas pagave të përhershme të punëtorëve.

9

Studimi i Remitencave në
Kosovë 2021, UNDP.




- Punësim i përhershëm
- Remitenca ndërkombëtare
- Dërgesa brenda Kosovës
- Punësim i përkohshëm
- Vetëpunësim
- Tjera

Burimi: Studimi i Remitencave në Kosovë 2012, UNDP

Megjithatë, për të kuantifikuar ndikimin e remitencave në aktivitetin ekonomik, është e nevojshme të shihet alokimi i tyre dhe kjo tregon që remitencat përdoren kryesisht për konsum të momentit nga marrësit e tyre. Ato përdoren kryesisht për blerje të produkteve ushqimore dhe pagesë të shpenzimeve komunale (rreth 35 për qind), pastaj për blerje të pajisjeve shtëpiake, veturave, etj. (24.8 për qind) si dhe për renovime e blerje të banesave apo shtëpive (gati 20 për qind). Vetëm një pjesë e vogël e remitencave (më pak se tetë për qind) përdoren për aktivitete produktive, përkatësisht 3.9 për qind të remitencave përdoren për investime biznesore dhe 3.7 për qind për kursime.

Shpërndarja e remitencave në përqindje, sipas kategorive të konsumit



Burimi: Studimi i Remitencave në Kosovë 2012, UNDP

Ndikimi i fuqishëm i remitencave në ekonominë e Kosovës është i pakontestueshëm. Kjo vërehet qartë nga pjesa e kontributit në BPB dhe rëndësia e tyre në burimet e të ardhurave për ekonominë familjare. Megjithatë, ndarja e remitencave, ku pjesa e shpenzuar në konsum të momentit mbizotëron, e parandalon mundësinë që këto transfere të shndërrohen në gjenerues të rritjes së mëturjeshe ekonomike apo në rritjen e zhvillimit në të ardhmen. Prandaj, fuqizimi i komponentës së investimit është mëse i nevojshëm, ndërsa vazhdimi i këtij trendi aktual do të mund të konsiderohej burim i pashfrytëzueshëm. Një strategji e qartë për këtë çështje nga administrata shtetërore mungon, megjithëse fokusi i organeve shtetërore por edhe sektorit joqeveritar rreth kësaj teme po lëviz ngadalë, kryesisht përmes njohjes dhe pranimit të ekzistimit të këtij potenciali të pashfrytëzuar.

Investime më intensive nga diaspora kërkojnë një ambient më të mirë ekonomik, ngase kushtet e biznesit në shtetet ku është e shpërndarë diaspora janë shumë tërheqëse. Pas kësaj, është e nevojshme që të krijohet një platformë që do të fuqizonte komunikimin dhe veprimin efikas, në aspekt të promovimit të pikave të investimit por edhe që do të neutralizonte barrierat administrative dhe që do të ulte shpenzimet para investimit. Po ashtu, ne shpeshherë hasim në paralajmërime që ky burim i financimit do të fillojë të zvogëlohet së shpejti për shkak të ndryshimit të natyrës së migrimit, e që aktualisht po dominohet nga migrimi familjar si dhe nga zhdukja natyrale e gjeneratave të vjetra e të cilët janë shqetësimi i diasporës dhe pranuesit e remitencave.

Në anën tjetër, pandemia globale e shkaktuar nga COVID-19 ka treguar që punët janë bërë më mobile se që është menduar ndonjëherë në të kaluarën, dhe që përpjekjet për të optimizuar shpenzimet do të rezultojnë në qëllime të theksuara për tu shpërngulur në vende më periferike. Kjo ngritë pyetjet rreth kualitetit të fuqisë punëtore dhe parimisht kualitetin e arsimit e që sot po bëhet një nga faktorët më të rëndësishëm në tërheqjen e investimeve të huaja direkte e veçanërisht nëse qëllimi është që të tërhiqen investime moderne, të sofistikuar dhe që janë miqësore ndaj ambientit.

Një burim i rëndësishëm që e posedon diaspora, pos remitencave, është edhe njohuria dhe aftësitë e fituara në vende me nivele më të larta të zhvillimit. Është e qartë që ky ndikim përveç efekteve ekonomike, ka edhe efekte sociologjike e kulturore, si dhe efekt në përmirësimin e institucioneve. Prandaj, po përmendet çdo herë e më shumë disa koncepte, përkatësisht qarkullimi apo lëvizja e njohurive, që do të mund të sigurojnë një përdorim më efikas të këtij burimi. Diaspora apo të kthyerit që janë të lidhur apo të përkushtuar ndaj shtetit të tyre amë shpesh vendosin edhe aftësitë e tyre ndermarrëse, organizative apo menaxheriale që janë fituar jashtë vendit dhe i sjellin ato në shërbime të fitimit. Përmes formave të ndryshme të praktikave trans-nacionale, ato mund të mbesin të lidhur me vendin e tyre amë por edhe me vende të tjera, pra, me njerëz, duke krijuar rrjete dhe duke inkurajuar shpërndarjen e teknologjisë së avancuar, metodave të menaxhimit, tregtinë moderne, ofrimin e shërbimeve etj. Edhe pa pasë kthim konstant në atdhe, mbajtja e lidhjeve të fuqishme me personat në diasporë mund të ketë ndikim pozitiv në normat e sjelljes. Ndikimi joformal i standardeve të miratuara dhe vlerave mund të krijojnë një presion të heshtur në institucione dhe të kontribuojnë në përmirësimin e të gjithë sistemit.

4 Përfundime



Ky punim ka për qëllim parësor të azhurojnë këtë temë dhe të nxisë audiencën profesionale dhe vendim-marrësit që të menaxhojnë me fenomenin e migrimit në mënyrën më të mirë të mundshme. Për këtë qëllim, janë bërë kuantifikime të caktuara dhe janë theksuar pikat kyçe ashtu që aktivitetet që ndërmerren për ta zgjidhur këtë çështje të jenë më efektive e mos të kenë efekte kundër-produktive. Ndalimi i këtij procesi apo kthimi i këtij trendi mbrapa është një mision i pamundur duke marrë parasysh një mori faktorësh, dhe ka të ngjarë që gjendja do të jetë e ngjashme edhe për shumë vite në të ardhmen. Megjithatë, minimizimi i efekteve negative dhe maksimizimi i ndikimit potencial duhet të fillojë tani.

Ky punim ka treguar që Kosova ndanë fatin e njejtë me regjionin në aspekt të lëvizjeve migruese dhe po përballet me në proces intensiv të emigrimit të rinjve dhe personave me arsimim të lartë. Nëse ky trend i emigrimit vazhdon, e ardhja do të sjellë disa probleme socioekonomike dhe do të rrisë edhe më shumë problemet që janë prezentë aktualisht. Presionet nga fondet pensionale, shërbimet shëndetësore e sociale, pengesat në pjesën e kërkesës në tregun e punës dhe rënia e potencialit të rritjes së BPV-së për shkak të përkeqësimit të faktorëve të kapitalit njerëzor, janë vetëm disa nga problemet me të cilat përballet shoqëria në Kosovë. Këta faktorë qëndrojnë në rrugën e prosperitetit kombëtar dhe një kualiteti më të mirë të jetës për secilin qytetar.

Rezultatet e nxjerra dhe qasja metodologjike janë një bazë e mirë për thellimin e mëtutjeshëm të analizës në të ardhmen, për të cilën është e nevojshme të ofrohen më shumë të dhëna për numrin e emigrantëve, moshën dhe strukturën arsimore të grupit të emigrantëve.

Kuantifikimi dhe analiza e gjendjes aktuale ka dëshmuar kompleksitetin e këtij fenomeni dhe ndikimin e tij të fuqishëm e shumë-dimensional në komunitet. Për më shumë, kalkulimet tregojnë që personat që po largohen nga Kosova, përveç njohurive dhe përvojës që e kanë fituar, “bartin” me vete edhe një vlerë të konsiderueshme nga fondet e investuara në arsimimin e tyre. Rezultatet tregojnë që kostoja e përgjithshme e arsimimit të personave që ikin nga Kosova brenda një viti, varësisht nga struktura arsimore, variron nga pak mbi €180 milionë e deri në €205 milionë. Kjo e vë të gjithë shoqërinë në pozitë të tillë ku diçka që do të duhej të ishte një investim, shndërrohet në shpenzim.

Rezultatet e fituara tregojnë që në mënyrë direkte apo indirekte, ngase nuk është e mundur të parandalohet ikja vjetor e popullatës përmes punësimit të tyre, humbja vjetore në nivelit të potencialit të BPV-së shkon në shumën prej rreth €519 milionësh. Është e qartë që kjo kosto nuk është e menjëhershme dhe që ndodh vetëm një herë, por që do të rritet tutje në të ardhmen përmes uljes së vlerës së kapitalit njerëzor që do ta shumëzojë kapitalin njerëzor. Mungesa e kapitalit njerëzor, në një të ardhme jo të largët, mund të determinojë në mënyrë të konsiderueshme faktin ekonomik të vendit dhe standardin e jetesës së të gjithë popullsisë kosovare.

Përderisa efekti negativ është i njohur dhe kuptohet, efektet pozitive janë prezentë vetëm në nivel të potencialit ndërsa aktivizimi i tyre kërkon aktivitete gjithëpërfshirëse nga institucionet publike, përkrahje nga sektori joqeveritar dhe një kuptim të qartë të gjendjes nga publiku. Edhe efekti më i drejtpërdrejt pozitiv, në formën e remitencave dhe transferove personale, ka fushëveprim shumë të limituar pa një qasje aktive të institucioneve relevante. Kjo vlen veçanërisht për shkak të natyrës së migrimëve moderne që dobësojnë ndjeshëm lidhjet me atdheun e rrjedhimisht edhe vetë fuqinë e këtyre transferove.

Burimet

- Studimi i Remitencave në Kosovë për vitin 2012, UNDP, 2012. https://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Remitances/KRS2012-Albanian-Electronic_551587.pdf.
- Varfëria në Konsum në Republikën e Kosovës, Banka Botërore dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. <https://ask.rks-gov.net/media/4901/poverty-statistics-2012-2017.pdf>.
- Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë, 2018. Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2019. <https://ask.rks-gov.net/media/5026/labour-force-survey-2018.pdf>.
- Studimi për Rininë - Kosovë 2018/19. Rrumbullaku, Oltion (2019).. <https://library.fes.de/pdf-files/id-moe/15264.pdf>.
- Rrëkeja e Kosovës në BE: Njerëzit, Arsyet dhe Mënyrat, Bardha Qirezi dhe të tjerët., Friedrich-Ebert-Stiftung, 2015. <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/13857.pdf>
- Migrimi në Kosovë, Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014. <https://ask.rks-gov.net/media/1380/kosovan-migration-2014.pdf>.
- Manuali mbi Burimet dhe Metodën e Përpilimit të Statistikave të KFQ (Klasifikimit të Funksioneve të Qeverisë) - (Manual on Sources and Methods for the Compilation of COFOG (Classification of Functions of Government) Statistics), Eurostat, Luksmburg. <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/10142242/KS-GQ-19-010-EN-N.pdf/ed64a194-81db-112b-074b-b7a9eb946c32>.
- Klasifikimi i Konsumit Individual Sipas Qëllimit (COICOP). 2018. Kombet e Bashkuara. https://unstats.un.org/unsd/classifications/unsdclassifications/COICOP_2018_-_pre-edited_white_cover_version_-_2018-12-26.pdf.
- Ligji Nr. 06/L-020 mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2018.
- Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 05 / L-125 mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2017.
- Ligji Nr. 05/L-109 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-071 mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2016.
- Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2015.
- Ikja në Vendet Anëtare të Bashkimit Evropian: Shkaqet dhe Pasojat e migrimit të fundit në Kosovë, Plator Avdiu, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, QKSS, 2015.
- Departure to the EU Member States: causes and consequences of Kosovo's recent migration - Policy Papers - KCSS (qkss.org)
- Shkaqet e Krizave të Migrimit të Parregullt: Rasti i Kosovës, Xhevdet Halili dhe Adrianit Ibrahimit, Strategos, Vlerësim Shkencor 1(2), 2017.
- Sistemi i Llogarive Kombëtare 2008, EC, IMF, OECD, UN, WB, 2009. <https://unstats.un.org/unsd/nationalaccount/sna2008.asp>.
- Emigrimi dhe Efektet e tij në Vendet Amë, Beth Asch, Center for Research on Immigration Policy, Santa Monica: Rand, 1994.
- Eksodi: Si po e Ndryshon Botën Migrimi, Paul Collier, Oxford: Oxford University Press, 2013.
- Vjetari Statistikor 2017, Agjencia e Statistikave të Kosovës,, 2018. <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/statistical-yearbook-2018>.
- Vjetari Statistikor 2017, Agjencia e Statistikave të Kosovës,, 2017. <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/statistical-yearbook-of-the-republic-of-kosovo-for-2017>.
- Vjetari Statistikor 2016, Agjencia e Statistikave të Kosovës,2016. <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/vjetari-statistikor-i-republikes-se-kosoves-per-vitin-2016>.
- Vjetari Statistikor 2015, Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2015. <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/statistical-yearbook-of-the-republic-of-kosovo-for-2015>.
- Migrimi Kosovar, Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2014. <https://ask.rks-gov.net/media/1380/kosovan-migration-2014.pdf>.
- Përlllogaritja e Popullësisë 2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018. <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/population-estimation-2018>.
- Niveli i Pagave në Kosovë, Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2019. <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/level-of-wage-in-kosovo-2012-2018>.
- Analizë e Sistemit të Arsimit në Kosovë, Luljeta Aliu, Friedrich-Ebert-Stiftung, 2019.



WESTMINSTER
FOUNDATION FOR
DEMOCRACY

Western Balkans
Democracy Initiative

